



UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
SENATI AKADEMIK

Nr. 1519/2021 prot.

Elbasan, më 22.07.2021

VENDIM

Nr. 17 datë 22.07.2021

“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PROGRAMIT TE STUDIMIT
“DOKTORATË NË SHKENCAT MJEKËSORE TEKNIKE””

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, Statutit të UE-së, neni 9, Rregullores së Studimeve në UE-së, me propozim të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, Senati Akademik më datë 22.07.2021,

VENDOSI:

1. Miratimin e Rregullores së programit të studimit “Doktoratë në shkencat mjekësore teknike”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike me zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Skender TOPI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE TEKNIKE

RREGULLORE


PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË DOKTORATËS NË SHKENCAT MJEKËSORE TEKNIKE

Neni 1

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të programit të studimit të ciklit të tretë, “Doktoratë në shkencat mjekësore teknike”.

Neni 2

Kjo Rregullore është hartuar në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018, “Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara Nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 112, datë 23.02.2018, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë ‘Profesor i Asociuar’ dhe ‘Profesor’, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 777, datë 26.12.2018, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.2.2018, “Për Miratimin e Modelit të Financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”; Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 16, datë 08.07.2019, “Për paisjen e institucioneve të arsimit të lartë me regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike dhe regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave”; Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe atij të Financave dhe Ekonomisë nr. 20, datë 20.9.2019 “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor”; Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 29, datë 18.12.2019 “Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë”; Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësi kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndajjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar; Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr.10, datë 30.3.2020



"Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në Regjistrin Shtetëror të Diplomave dhe Certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor"; Udhëzimit të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL"; si edhe Statutit të Universitetit të Elbasanit.

Neni 3

3.1 Programet e studimit të doktoratës përfshihen në ciklin e tretë të studimeve universitare, në përfundim të të cilit lëshohet diploma për gradën shkencore "Doktor".

3.2 Programi i doktoratës synon të nxisë kërkimin shkencor, duke u orientuar drejt thellimit, rikonceptimit dhe riintegritit të njohurive shkencore, për të sjellë risi në mendimin shkencor.

3.3 Studimet e doktoratës kanë në themel të tyre kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese të pavarur, si bazë për përgatitjen e tezës së doktoratës, të nevojshme për marrjen e gradës "Doktor" dhe lidhen me projekte kërkimore të njësisive bazë apo të njësisive kryesore.

3.4 Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor, në fushat e përcaktuara nga njësitë bazë ose njësia kryesore. Njësitë bazë shpallin fushat kryesore sipas objektivave të tyre, ose fusha të përbashkëta ndërmjet tyre me prioritet për thellimin e kërkimit shkencor.

Neni 4

4.1 Njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknikë, janë përgjegjëse për organizimin dhe drejtimin e programit të studimit të doktoratës. Kriteret e pranimit të studentëve për në programin e studimit të doktoratës të përcaktuara nga njësitë bazë, i përcillen Dekanati. Njëra prej njësisive bazë caktohet si përgjegjëse për ofrimin e programit të kërkimit të kandidatit, në dakordësi midis tyre.

4.2 Programi i Studimit të Doktoratës drejtohet nga Dekani, në funksionin e Koordinatorit të Doktoratës.

4.3 Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore "Doktor" është përgjegjës për të vlerësuar dosjen e disertantit, ngritjen e jurisë dhe për të marrë vendime për dhënien e gradës shkencore "Doktor".

4.4 Vlerësimi i disertacionit të kandidatit për gradën shkencore "Doktor" realizohet nga Juria e posaçme, e ngritur për këtë qëllim.



Neni 5

5.1 Për të kryer regjistrimin në programet e studimit të doktoratës, aplikanti duhet të plotësojë këto kritere:

- të ketë përfunduar studimet e larta në shkencat mjekësore teknike dhe të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”; një diplomë të integruar të nivelit të dytë, ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barsavlershëm, të fituar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente”;
- të ketë notë mesatare, mbi 8 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë. Përfashohen nga plotësimi i kriterit të notës mesatare, kandidatët e diplomuar jashtë vendit;
- të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja: *anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht*, në përputhje me nivelin e parashikuara në Udhëzimin Nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar;
- të ketë dy rekomandime nga persona, që kanë titullin Profesor ose Profesor i Asociuar, të cilët njohin aftësitë kërkimore shkencore dhe profesionale të kandidatit;
- të ketë paraqitur projektin kërkimor, në përputhje me projektin “Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore të profesioneve mjekësore teknike në Qarkun e Elbasanit”, në momentin e aplikimit;
- të parqesë një përmbledhje të temës së masterit (4 fage), për studentët e që zotërojnë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”;
- të ketë publikime të mëparshme kërkimore shkencore;
- të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjiaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike.

5.2 Aplikanti për të ndjekur programin e studimit të doktoratës bën një kërkesë, ku paraqet edhe propozimin për temën dhe objektivat e kërkimit shkencor. Kjo kërkesë përfshihet në dosjen personale, e cila përmban edhe dokumentet e mëposhtme:

- curriculum vitae;
- kopje të noterizuara të diplomave, të shogërnara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shogërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalencimit nga ministria përgjegjëse për arsimin;
- certifikatë lindjeje, si edhe fotokopje të kartës së identitetit/ pasaportës;
- dy rekomandime nga persona me titullin Profesor ose Profesor i Asociuar;
- dëshmi të gjuhës së huaj, përputhje me nivelin e parashikuara në Udhëzimin Nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar;
- dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer, pjesëmarrje në konferenca shkencore apo eksperiencia akademike;
- deklaratë vetjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës, nëse do të vetëfinancohet;



- projekt propozimin e kërkitit shkencor, ku të evidentohen qëllimi dhe objektivat, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë që pritet të sjellë punimi;
- vërtetim nga qendra e punës, nëse kandidati është i punësuar;
- mandat pagese për tarifën e aplikimit;
- vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike;
- vetëdeklarim që nuk është subjekt i asnjë mase disiplinore të marrë ndaj tij.

5.3. Udhëheqësi shkencor për studentin aplikant në programin e studimit të doktoratës duhet të ketë titullin “Profesor” ose “Profesor i Asociuar”. Numri i doktoratëve që mund të udhëheqë personeli akademik në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, ku ai është angazhuar është:

- jo më shumë se 3 (tre) në rastin e personelit akademik që mban titullin “Profesor”;
- jo më shumë se 2 (dy), në rastin e personelit akademik që mban titullin “Profesor i asociuar”;

5.4 Dosja e kërkesës për regjistrim në programin e studimeve të doktoratës shqyrtohet Kolegji Doktorat, i cili përcakton metodologjinë dhe procedurat e vlerësimit të kandidatëve, të cilat bëhen transparente, shpallen dhe publikohen, së bashku me afatet e shqyrtimit të dosjeve.

5.5 Kolegji Doktorat bën përzgjedhjen dhe renditjen e kandidatëve, mbështetur në propozimin e aplikantit dhe në dokumentacionin në dosjen përkatëse, mbi pikezimin e kriterëve specifike të aplikatëve. Tabela e pikezimit është bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

5.6 Kandidati ka të drejtë të ankinojë procedurën e vlerësimit të kandidatëve, brenda tri ditëve pune nga shpallja e listës paraprake të kandidatëve fitues. Ankimi bëhet pranë Dekanatit.

5.7 Midis kandidatit fitues dhe njësisë kryesore lidhet një kontratë, që rregullon aspektet akademike dhe financiare.

Neni 6

Studimet e doktoratës ndërtohen mbi programe individuale për aftësim të pavarur të kandidatëve në kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara nga njësia bazë ose njësia kryesore. Ato kanë në themel kërkimin shkencor dhe veprimtaritë krijuese. Viti doktorat do të realizohet duke patur parasysh kohëzgjatjen 3 deri 5 vjet, si në vijim:



Elementët e planit vjetor (3 vite)						
I	Formimi teorik e shkencor	Prezantimi me konferenc	Aktivitetet specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor	Asistencë mesimdhënie lidhur me tashën e kërkimit shkencor	Shtyrimi i literaturës	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën gjetimi, metoda e kërkimit, burimet e nevojshme, dhe rezultatet e pritshme
		Prezantimi me konferenc	Aktivitetet specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor	Asistencë mesimdhënie lidhur me tashën e kërkimit shkencor	Shtyrimi i literaturës	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën gjetimi, metoda e kërkimit, burimet e nevojshme, dhe rezultatet e pritshme
II	Permuftesim ndryshim i planit të projektit shkencor ose fillimi i tij nëse është miratuar nga komisioni përkatës	Aktiviteti Klinik në spital ose institucione të tjera shëndetësore sipas fokusit të kërkimit	Publikime shkencore mbi gjetjet nga literatura	Zbatim i projektit shkencor	Shtyrimi i literaturës dhe Analiza statistikore	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën gjetimi, metoda e kërkimit, burimet e nevojshme, dhe rezultatet e pritshme
III	Shtimi i disertacionit	Prezantimi në aktivitetet shkencore (konferenca seminarë) me interes në fushën kërkimore	Prezantimi i punimeve mbi departamentin	Përfundimi i disertacionit dhe detyrimeve të tjera si doktorant	Dorëzimi i disertacionit të komisionit	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën gjetimi, metoda e kërkimit, burimet e nevojshme dhe rezultatet e pritshme

Elementët e planit vjetor (5 vite)						
I	Formimi teorik e shkencor	Prezantimi me konferenca	Aktivitetet specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor	Asistencë në mesimdhënie lidhur me tashën e kërkimit shkencor	Shtyrimi i literaturës	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën gjetimi, metoda e kërkimit, burimet e nevojshme dhe rezultatet e pritshme
		Prezantimi me konferenca	Aktivitetet specifike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor	Asistencë në mesimdhënie lidhur me tashën e kërkimit shkencor	Shtyrimi i literaturës	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën gjetimi, metoda e kërkimit, burimet e nevojshme dhe rezultatet e pritshme
II			Aktiviteti Klinik në spital ose institucione të tjera shëndetësore sipas fokusit të kërkimit	Publikime shkencore mbi gjetjet nga literatura	Shtyrimi i literaturës	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën gjetimi, metoda e kërkimit, burimet e nevojshme dhe rezultatet e pritshme
III	Paramezim ndryshimi i planit të projektit shkencor ose fillimi i tij nëse është miratuar nga komisioni përkatës	Aktiviteti Klinik në spital ose institucione të tjera shëndetësore sipas fokusit të kërkimit	Publikime shkencore mbi gjetjet nga literatura	Zbatim i projektit shkencor	Shtyrimi i literaturës dhe Analiza statistikore	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën gjetimi, metoda e kërkimit, burimet e nevojshme dhe rezultatet e pritshme
IV	Zbatim i projektit	Aktiviteti Klinik në spital ose institucione të tjera shëndetësore sipas fokusit të kërkimit	Shtyrimi i literaturës	Shtyrimi i literaturës	Shtyrimi i literaturës	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën gjetimi, metoda e kërkimit, burimet e nevojshme dhe rezultatet e pritshme
V	Shtimi i disertacionit	Prezantimi në aktivitetet shkencore (konferenca seminarë) me interes në fushën kërkimore	Prezantimi i punimeve mbi departamentin	Përfundimi i disertacionit dhe detyrimeve të tjera si doktorant	Dorëzimi i disertacionit të komisionit	Hartimi i planit të projektit të kërkimit ku të përfshihen të paktën gjetimi, metoda e kërkimit, burimet e nevojshme dhe rezultatet e pritshme

Neni 7

7.1 Gjatë periudhës së studimeve të doktoratës, para paraqitjes për mbrojtje, studenti duhet të ketë plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) Të ketë realizuar së paku, 3 (tri) referime ose paraqitje shkencore, si autor i parë ose i dytë, kur autori i parë është udhëheqësi shkencor, nga të cilët dy referime ose paraqitje të jetë mbajtur në një veprimtari shkencore/profesionale ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) në një nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian, OECD, ose të G-20-ës, të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “proceedings”, të indeksuar me kod ISBN-je ose ISSN;



b) Të ketë botuar së paku 3 (tre) artikuj shkencorë në revista shkencore, nga të cilët 1 (një) të jetë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të rankuara në *Journal Citation Reports* ose *Scopus*, ku është së paku autor i dytë;

c) Të ketë përfunduar disertacionin, sipas formatit të përcaktuar në këtë rregullore dhe në rregulloret e lidhura me programin e tij të studimit. Disertacioni duhet të jetë në respektim të kuadrit ligjor dhe nënligjor, si edhe të akteve të miratuara nga UE, në lidhje me Integritetin në Kërkimin Shkencor.

7.2 Të paktën një herë në vit, në fund të çdo viti akademik, Kolegji Doktorat duhet të shqyrtojë ecurinë e punës së studentit në programin e studimeve të doktoratës, bazuar në prezantimet vjetore të punës, që bën doktoranti dhe vlerësimet me shkrim që bën udhëheqësi, sipas një formati të paracaktuar.

7.3 Disertacioni së bashku me dosjen, që përban dokumentacionin që tregon plotësimin e kriterëve si më sipër, i dorëzohet Kolegjit Doktorat, i cili vlerëson për të vijuar më tej me procedurat për mbrojtje, sipas përcaktimeve në vijim në këtë rregullore.

Neni 8

8.1 Studenti ka të drejtë:

- a)** të pajiset me paketën e akteve ligjore dhe nënligjore, që janë në funksion të procesit të studimeve të doktoratës dhe mbrojtjes së disertacionit për fitimin e Gradës Shkencore “Doktor”;
- b)** të kërkojë krijimin e kushteve për ndjekjen e veprimtarive akademike dhe shkencore të parashikuara në programin e tij të studimeve të doktoratës;
- c)** të shfrytëzojë bibliotekën e njësisë kryesore apo të njësive të tjera të UE-së, në varësi të specifikave përkatëse të kërkimit;
- ç)** të shfrytëzojë bibliotekat e njësive të institucioneve me të cilat Universiteti i Elbasanit, ka marrëveshje bashkëpunimi në fushën akademike apo/dhe shkencore, duke paraqitur pranë këtyre institucioneve dokumentin e lëshuar nga njësia kryesore, mbi qëllimin e studimit të kërkimit dhe statusin e tij si student i cikli të tretë;
- d)** të shfrytëzojë ambjentet studimore/kërkimore dhe bazën e të dhënave pranë institucioneve publike/privatë, që do të mund t'i nevojiten atij për kërkimin shkencor, mbi bazën e rekomandimeve që njësia kryesore do të lëshojë rast pas rasti;
- dh)** të tërhiqet vullnetarisht nga studimet e doktoratës, duke paraqitur kërkesën me shkrim pranë njësisë bazë.

8.2 Studenti ka për detyrë:

- a)** të njohë dhe të plotësojë të gjitha detyrimet ligjore që rrjedhin nga kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi, përfshirë dhe këtë rregullore;
- b)** të respektojë programin e miratuar të kërkimit të doktoratës.



- c) të respektojë afatet e parashikuara për realizimin e studimeve të doktoratës; dhe shlyerjen e detyrimeve financiare (për studentët që janë me vetëfinansim);
 - e) të raportoje, të paktën një herë në vit, mbi ecurinë e punës për realizimin e programit të kërkimit dhe veprimtarinë e tij kërkimore-shkencore;
 - d) të zbatojë standardet shkencore dhe etike të parashikuara për doktoratën në këtë rregullore dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore;
- dh)**
të respektojë kuadrin ligjor për etikën dhe integritetin në Kërkimin Shkencor gjatë hartimit të disertacionit;
- e) të dorëzojë brenda afateve ligjore disertacionin dhe dosjen përkatëse, sipas përcaktimeve në këtë rregullore, akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - f) të kryejë pagesën vjetore të ciklit të studimit, para fillimit të çdo viti akademik.

Neni 9

9.1 Udhëheqësi/ udhëheqësit shkencorë kanë përgjegjësitë si në vijim:

- Të garantojë zbatimin e të gjitha rregullave shkencore dhe etike të kërkimit shkencor, gjatë periudhës së udhëheqjes së doktoratës.
- Të udhëheqë studentin për realizimin e kërkimit shkencor dhe përfundimin e disertacionit brenda kohës së parashkuar në aktet ligjore dhe nënligjore.
- Të japë mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit arritjen e standardeve të larta të kërkimit shkencor. Kjo përfshin, ndër të tjera, edhe orientim në lidhje me strukturën e punimit, metodologjinë, rekomandime mbi literaturën dhe burime të tjera të informacionit, si edhe konsulencë të vazhdueshme për përmbytjen e punimit.
- Të mbajë komunikime të rregullta me studentin për ecurinë e punimit shkencor.
- Të vlerësojë progresin e studentit rregullisht dhe të monitorojë punën e tij në përputhje me standardin e kërkuar. Të ndërjegjësojë studentin, në rastet kur puna e tij është nën standardin e kërkuar dhe të ndërmarrë veprimet e duhura mbështetëse.
- Të mbështesë studentin për përgatitjen e materialeve kërkimore, përfshirë artikuj dhe prezantime për konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në botime të tjera shkencore, kur tematika e tyre është në funksion të kërkimit shkencor dhe punimit të doktoratës dhe në pëmbushje të kriterëve të përcaktuara.
- Të kontrollojë se kandidati i ka plotësuar të gjitha vërejtjet dhe rekomandimet, në rastet kur njëjsia bazë e ka kthyer punimin për riparagjije dhe/ose plotësimin e dosjes.



- Në rastet e bashkëudhëheqjes, udhëheqësit duhet të përcaktojnë qartë përgjegjësitë e tyre dhe duhet të mbajnë kontakte të rregullta.

Neni 10

10.1 Kolegji Doktoratës është struktura përgjegjëse për zhvillimin e punës për kërkimin shkencor, për hapjen dhe riorganizimin e programit të doktoratës dhe ndjekjen e të gjitha fazave të procesit të doktoratës.

10.2 Kolegji përbëhet nga personeli akademik i cili është ngarkuar me udhëheqjen e studimeve doktorale si dhe Koordinatorin e Doktoratës. Kryetar i kolegjit zgjidhet Profesori më i moshuar.

10.3 Kolegji Doktoratës përcakton dhe miraton projektet kërkimore të secilit doktorant.

10.4 Kolegji Doktoratës miraton udhëheqësit e punimeve të doktoratës.

10.5 Kolegji Doktoratës ka përgjegjësi të garantojë përmbushjen e kriterëve formale nga kandidatët, përpara shqyrtimit të dosjes së tyre nga Komisioni për Dhënien e Gradave.

10.6 Kolegji Doktoratës ka përgjegjësi të shqyrtojë raportet e ecurisë së kërkimit shkencor, të paraqitura nga studentët dhe udhëheqësit dhe të garantojë se udhëheqësit kanë kontakt të rregullt me studentët. Në rastet kur konstaton probleme, propozon ndryshimet e nevojshme.

10.7 Kolegji Doktoratës ka përgjegjësi të informojë studentët e pranuar në programin e saj të doktoratës për aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse, përfshirë edhe këtë rregullore, që lidhen me procesin e fitimit të gradës shkencore.

10.8 Në kushtet e kërkesës për ndryshimin e temës së disertacionit, doktoranti paraqet një raport drejtuar Kolegjit Doktoratës, të nënshkruar prej tij dhe udhëheqësit, ku të argumentohet ndryshimi i temës. Kolegji Doktoratës, vendos për miratimin ose jo të ndryshimit të temës së disertacionit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dorëzimi i kërkesës.

Neni 11

Programi i doktoratës ndiqet nga koordinatori i Studimeve të Doktoratës, i cili ka përgjegjësi:

- a)** Të mbikqyrë dhe të sigurojë që njësitë bazë respektojnë, në ushtrimin e përgjegjësisive të tyre në lidhje me programet e studimit të doktoratës, kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, përfshirë edhe këtë rregullore, si dhe:
- respektimin e afatave dhe të kriterëve për shpalljen e hapjes së programit të doktoratës;
 - respektimin e rregullave në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve fitues;
 - respektimin e kriterëve në lidhje me udhëheqësit shkencorë, përfshirë, por jo vetëm, kriteret në lidhje me titullin shkencor, që duhet të ketë udhëheqësi (“Profesor” dhe “Profesor i asociuar”), numrin maksimal të doktorantëve që mund të udhëheqë, ekspertizën në fushën specifike të kërkimit si edhe mundësitë reale në ofrimin e një udhëheqëje cilësore për kandidatët;



- respektimin e procedurave të udhëheqjes dhe shqyrtimit të ecurisë së kërkimit shkencor.

b) Të mbikëqyrë dhe të sigurojë që studentët e doktoratës të informohen për të gjitha aktet ligjore, nënligjore, udhëzime dhe rregullore, që kanë të bëjnë me procesin e fitimit të gradës shkencore “Doktor”.

Neni 12

12.1 Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” është Komision i përhershëm që ngrihet në nivel njësie kryesore. Ai është përgjegjës për monitorimin e procesit të dhënies së gradës shkencore “Doktor”.

12.2 Komisioni përbëhet nga jo më pak se 5 (pesë) anëtarë dhe jo më shumë se 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, të cilët zgjidhen me vetëkandidim nga radhët e Asamblesë së personelit akademik. Anëtarët duhet të kenë titullin akademik ‘Professor’ ose ‘Professor i Asociuar’ dhe të kenë jo më pak se 10 (dhjetë) vite përvojë pune me kohë të plotë, si personel akademik.

12.3 Komisioni është përgjegjës për shqyrtimin e dosjes së Kandidatit dhe nëse vlerëson që dosja përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe përmbush kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, ngre Jurinë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja në shqyrtim e dosjes.

12.4 Komisioni është organi kompetent për vendimmarrjen në lidhje me dhënien e gradës Shkencore “Doktor”, pas shqyrtimit të raportit të vlerësimit të Jurisë.

Neni 13

13.1 Studimet e doktoratës zgjasin jo më pak se 3 (tri) vite akademike dhe jo më shumë se 5 (pesë) vite akademike.

13.2 Në raste përjashtimore, me kërkesë të studentit, komisioni mund të vendosë vetëm një herë për shtyrjen ose për pezullimin e studimeve të doktoratës, por jo më shumë se 2 (dy) vite në total.

Neni 14

14.1 Mbrojtja e doktoratës bëhet përpara një jurie të përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 2 (dy) anëtarë i përkasin staffit akademik të njësive bazë nga institucionet homologe vendase ose të huaja.

14.2 Ngriçja e Jurisë bëhet pasi kandidati i ka plotësuar të gjitha kërkesat e parashikuara në këtë rregullore dhe ka përfunduar disertacionin e tij. Ai e dorëzon disertacionin e përfunduar, së bashku me dosjen, pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell për vlerësim njësisë bazë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e dorëzimit. Pas vlerësimit nga njëسيا bazë,



disertacioni dhe dosja e kandidatit i përcillen Komisionit për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Komisioni, nëse e vlerëson pozitivisht dosjen, brenda 30 (tridhjetë) ditëve ngre jurinë për vlerësimin e disertacionit.

14.3 Komisioni për Dhënien e Gradave përzgjedh anëtarët e jurisë nga një listë me jo më pak se 8 (tetë) anëtarë, propozuar nga njëسيا bazë dhe miratuar nga drejtuesi i njësisë kryesore. Anëtarët e jurisë duhet t'i përkasin kategorisë “Profesor” dhe/ose “Profesor i Asociuar”. Dy anëtarë të jurisë caktohen oponentë për vlerësimin e disertacionit, ku njëri është anëtar i jashtëm. Njëri prej anëtarëve të jurisë caktohet kryetar i saj.

14.4 Juria cakton datën e mbrojtjes së disertacionit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga formimi i saj.

14.5 Kur, për arsye të përligjura, njëri nga anëtarët e jurisë nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës, përgjegjësi i njësisë bazë vë në dijeni drejtuesin e njësisë kryesore, duke i propozuar edhe një datë tjetër për mbrojtjen. Drejtuesi i njësisë kryesore vë në dijeni Komisionin për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”. Juria merr vendim për ndryshimin e datës së mbrojtjes së doktoratës pas njoftimit dhe miratimit paraprak nga Komisioni për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”. Kjo procedurë zbatohet edhe në rastin kur doktoranti, për arsye të përligjura, nuk mund të jetë i pranishëm në datën e caktuar për mbrojtjen e doktoratës.

14.6 Pas prezantimit të disertacionit nga doktoranti, juria harton raportin e vlerësimit dhe ia dërgon atë Komisionit për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”.

14.7 Komisioni për dhënien e Gradave, pasi merr Raportin e Vlerësimit nga Juria, brenda 10 (dhjetë) ditëve, merr vendimin mbi dhënien e gradës shkencore “Doktor” dhe ia përcjell atë për procedura të mëtejshme drejtuesit të njësisë kryesore.

Neni 15

15.1 Mbrojtja e doktoratës bëhet si rregull, e hapur, me përjashtim të rasteve kur, për natyrën e veçantë të gëshfjerve të trajtuara (sekrete, të dhëna konfidenciale etj.) duhet të bëhet e mbyllur. Drejtuesi i njësisë kryesore, me kërkesë të njësisë bazë, autorizon mbrojtjen me publik të kufizuar, sipas propozimit të Komisionit për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”.

15.2 Disertacioni prezantohet para jurisë, e cila e vlerëson atë.

15.3 Procedura e mbrojtjes së disertacionit përfshin:

- paraqitjen nga kryetari i jurisë të dokumentacionit të dosjes, përbërjes së jurisë dhe deklarimit nga ana e tij për hapjen e procedurës së mbrojtjes;
- paraqitjen e disertacionit nga studenti për një kohë prej 25-30 minuta;
- paraqitjen e oponencave. Oponentët japin vlerësimin me shkrim të disertacionit, ku saktësohet nëse punimi në tërësi i përmbush kërkesat e paraqitura në programin e doktoratës, duke iu kushtuar vëmendje vlerave origjinale, që paraqet punimi, si dhe duke vënë në dukje pikat e forta e të dobëta të tij (nëse ka të tilla);



- pyetje nga të pranishmit rreth disertacionit dhe opionecave, drejtuar studentit doktorant;
- diskutime;
- sqarime eventuale nga studentit doktorant dhe udhëheqësi shkencor;
- shpërndarjen e fletëvotimeve të hapura e të paplotësuara dhe votim i fshehtë për vlerësimin e doktoratës;
- pasqyrimin në procesverbal të rezultatit të votimit dhe shpalljen e vendimit me shkrim.

15.4 Punimi vlerësohet me pikë, nga 0 – 100 pikë. 100-80% e pikëve të mundshme = “shumë mirë”, 79-65% e pikëve të mundshme = “mirë”, 64-50% e pikëve të mundshme = “njëftueshëm”, 49% e më pak e pikëve të mundshme = “pakalueshëm”.

15.5 Pas mbrojtjes së doktoratës, njësia kryesore përcjell një kopje të disertacionit në Bibliotekën Kombëtare, një kopje në bibliotekën shkencore të njësisë kryesore dhe një kopje në formatin elektronik në Universitein e Elbasanit.

15.6 Në përfundim të studimeve lëshohet diploma e gradës shkencore “Doktor”, e cila nënshkruhet nga drejtuesi i njësisë kryesore dhe rektori.

15.7 Lista e të diplomuarve në programet e ciklit të tretë i përcillet Universitetit të Elbasanit dhe prej andej Ministrisë përgjegjëse për arsimin, për t’u pasqyruar në regjistrin shtetëror të gradave shkencore e tijnjve akademikë dhe në regjistrat përkatës të IAL-së.

Neni 16

Në rast se doktoranti nuk arrin të përfundojë ose ndërpret përgatitjen e disertacionit brenda afatit të caktuar, ai mund të pajiset me një vërtetim për rezultatet e arritura. Vërtetimi lëshohet nga drejtuesi i njësisë kryesore, pas konceptimit nga drejtuesi i njësisë bazë në lidhje me arritjet e studentit të doktoratës. Drejtuesi i njësisë kryesore vë në dijeni Komisionin për dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”.

Neni 17

17.1 Nëse pas mbrojtjes së disertacionit ka të dhëna të besueshme, konstatohet dhe/ose vërtetohet se grada “Doktor” është është fituar në shkëlqje të rregullave të etikës mbi kërkimin shkencor, ose kur mbrojtja është bërë në kundërshtim me kuadrin ligjor, fillon procedura për anulimin e kësaj grade. Rregulloret e njërive kryesore përcaktojnë më tej procedurat, që do të ndiqen për anulimin e gradës ‘Doktor’.

17.2 Personi për të cilin fillon procesi i shqyrtimit të gradës, duhet të njoftohet në lidhje me shkakun, procedurat që do të ndiqen dhe mbi të drejtën që ka për t’u mbrojtur, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 18

18.1 Punimi hartohet në gjuhën shqipe dhe një përmbledhje e tij (2000-4000 fjalë) hartohet në një nga pesë gjuhët e Bashkimit Europian (*anglisht, frëngjisht, gjermanisht, spanjisht, italisht*),



në format të shtypur dhe elektronik. Përpapa dorëzimit punimi miratohet nga udhëheqësi shkencor.

18.2 Punimi lidhet në pesë kopje origjinale. Në kopertinë duhet të vendoset:

- Emri i Universitetit (në krye, në mes të kopertinës);
- Emri i Fakultetit (në krye, mes të kopertinës);
- Emri i Departamentit, ku është zhvilluar programi i doktoratës (në krye, në mes të kopertinës);
- Stema e Universitetit (në krye, në anën e majtë të kopertinës);
- Stema e Fakultetit (në krye, në anën e djathtë të kopertinës);
- Fjala DISERTACION (në mes të kopertinës);
- Emri i programit të doktoratës (në mes të kopertinës);
- Emri i kandidatit (në fund, në anën e majtë të kopertinës);
- Emri dhe grada e Udhëheqësit (në fund, në anën e djathtë të kopertinës);
- Qyteti dhe viti i mbrojtjes (në fund, në mes të të kopertinës).

18.3 Njësitë kryesore përcaktojnë në rregulloret e tyre specifikkimet teknike për punimin, si: kriteret për formatin, gjatësinë e punimit, llojin e letrës, hapësira midis rreshtave, llojin e shkimit, marginat, emërtimi, shënimet, tabelat, diagramet, materialet shoqëruese, citimet dhe referencat dhe çdo element tjetër të lidhur me formatimin.

Neni 19

19.1 Çdo punim duhet të reflekttojë rregullat, që lidhen me etikën e punës kërkimore dhe integritetin akademik, në respektim të kuadrit ligjor për Etikën dhe Integritetin në kërkimin shkencor.

19.2 Kur dorëzon disertacionin, kandidati duhet të deklarojë me shkrim se studimi është punë origjinale e tij.

19.3 Kandidati nuk lejohet të paragësë të njëtin punim, që e ka paraqitur më parë në të njëjten njësi ose në një njësi tjetër për matjen e një grade tjetër. Punimi i doktoratës mund të përfshijë pjesë të studimeve të mëparshme, nëse ai tregon qartë në disertacion se cila pjesë e punës është përdorur më parë. Rregulloret e njëjrive kryesore përcaktojnë masën, që lejohet të përfshihet nga punimet e mëparshme, në disertacionin e doktoratës.

19.4 Kandidati mund të përfshijë në disertacion edhe pjesë nga studime individuale apo të realizuara me bashkautorë, ose të dhëna të përfutuara nga kërkime në kuadër të projekteve kërkimore të tjera. Nëse kërkimi është realizuar në ekip, kandidati e evidenton këtë fakt dhe njih kontributin e bashkëpunëtorëve.

19.5 Gjatë periudhës së përgatitjes së disertacionit, kandidati mund të botojë pjesë të studimit shkencor në formën e artikujve apo të referimeve shkencore.

19.6 Punimi nuk duhet të përmbajë elemente, që përbëjnë plagjiaturë. Në çdo rast që përdoren ide, fjalë apo koncepte nga burime të tjera duhet të citohen referenca përkatëse.



19.7 Nëse burimi original nuk gjendet, por ai është përmendur në një dokument tjetër, atëherë duhet të citohen të dy dokumentet, burimi original dhe burimi dytësor.

19.8 Udhëheqësi duhet të sqarojë kandidatin, që në fillim të punës, për trezikun dhe pasojat në rastet e konstatimit të mashtrimit, falsifikimit dhe plagjiaturës.

19.9 Pronësia intelektuale, e drejta e autorit për punimin (si edhe për çdo material të botuar), mbrohet nga ligji i së drejtës të autorit dhe akte të tjera të zbatueshme në këtë drejtim. Shënimi për rezervimin e së drejtës së autorit, simboli përkatës ©, emri i zotëruesit të autorësisë, viti i punimit duhet të vendosen në faqen, që vjen pas titullit të punimit.

Neni 20

20.1 Kandidatët që ndjekin një program studimesh të doktoratës në institucione të arsimit të lartë, vendas ose të huaj, kanë të drejtë të transferojnë këto studime, kur fushat e studimit janë të njëjta ose të ngjashme.

20.2 Transferimi mund të kryhet në/nga një institucion tjetër të arsimit të lartë, publik, jopublik, vendas ose të huaj.

20.3 Kur transferimi kërkohet nga një kandidat i një institucioni tjetër të arsimit të lartë për në UE dhe programi i doktoratës kryhet me vetëfinansim, transferimi kryhet duke mbajtur parasysht kriteret e parashikuara nga kjo rregullore për pranimin në një program studimi të doktoratës.

20.4 Kur burimi i financimit është i ndryshëm nga ai i përcaktuar në pikën 2, transferimi kryhet në varësi të burimit të financimit.

Neni 21

21.1 Kur kandidati kërkon të transferojë studimet në UE, kërkesa për transferim dhe dokumentacioni, paraqitet pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili pasi verifikon fushën e studimit të doktoratës, i cili ia përcjell njësisë bazë që mbulon këtë fushë studimi.

21.2 Njësia bazë ngre një Komision *ad hoc* për verifikimin e plotësimit të kriterëve të pranimit në një program studimi të doktoratës dhe burimin e financimit. Komisioni shqyrtton kërkesën për transferim brenda dy muajve nga data e paraqitjes së saj.

21.3 Ndaj vendimit të Komisionit, kandidati ka të drejtën e ankimit tek drejtuesi i njësisë kryesore, i cili shprehet me vendim brenda një muaji nga data e paraqitjes së saj.

Neni 22

22.1 Kur kandidati kërkon të transferojë studimet nga UE, në një institucion tjetër të arsimit të lartë, vendas ose të huaj, kërkesa për transferim paraqitet pranë drejtuesit të njësisë kryesore, i cili ia përcjell njësisë bazë pranë të cilit po zhvillohet ky program studimi. Në këtë rast, Komisioni verifikon vetëm burimin e financimit të programit të doktoratës.

22.2 Kandidati ka të drejtë të pajiset me një dokument që vëreton arritjet e tij deri në momentin e transferimit të studimeve nga UE.



Neni 23

Kjo rregullore zbatohet për studentët që do të regjistrohen në programin e studimit të doktoratës pas hyrjes në fuqi të saj.

Neni 24

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Senati Akademik i Universitetit të Elbasanit.



Shkajca Nr.1

Mbi pikëzimin ne procesin e konkurimit në programin e studimit Doktoratë në Shkencat Mjekësore Teknike

Doktoratë në Shkencat Mjekësore Teknike	
Viti akademik 2021 -2022	
Vënde të disponueshme	5
Kohëzgjatja e programit	Studimi me kohë normale, shprehur në vite: 3 Studimi kohë të zgjatur, shprehur në vite: 5
Kurrikula	Shkenca Mjekësore Teknike
Strukturat përgjegjëse	Departamenti i Infermieristikës, Departamenti i Lëndëve Paraklinike Departamenti i Lëndëve Klinike, Departamenti Specialiteteve Tekniko-Mjekësore
Faqja eëb	https://uniel.edu.al/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-mjekesore-teknike
Koordinatori	Prof.as.dr. Shkëlqim Hidri shkelqim.hidri@uniel.edu.al
Kriteret e pranimiit	<p>Për të kryer regjistrimin në programet e studimit të doktoratës, aplikanti duhet të plotësojë këto kriteret:</p> <ul style="list-style-type: none">te ketë përfunduar studimet e larta në shkencat mjekësore teknike dhe të zotërojë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”; një diplomë të integruar të nivelit të dytë, ose një diplomë sipas sistemit të vjetër apo titull akademik të barasvlershëm, të ftuar jashtë vendit dhe të njohur nga organet kompetente”;të ketë notë mesatare, mbi 8 (tetë) në studimet e ciklit të parë dhe të dytë. Përfashohen nga plotësimi i kriterit të notës mesatare, kandidatët e diplomuar jashtë vendit;të ketë mbrojtur një nga gjuhët e huaja: <i>anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht ose spanjisht</i>, në përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin Nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar;



	<ul style="list-style-type: none"> • të ketë dy rekomandime nga persona, që kanë titullin profesor ose profesor i asociuar, të cilët njojnë aftësitë kërkimore shkencore dhe profesionale të kandidatit; • të ketë paraqitur projektin kërkimor, në përputhje me projektin “Rritja e kapaciteteve kërkimore shkencore të profesioneve mjekësore teknike në Qarkun e Elbasanit”, në momentin e aplikimit; • të paraqesë një përmbledhje të temës së masterit (4 faqe), për studentët e që zotërojnë një diplomë të ciklit të dytë “Master i shkencave”/“Master i arteve”; • të ketë publikime të mëparshme kërkimore shkencore; • të mos jenë marrë masa disiplinore ndaj tij apo të mos jenë gjetur shkelje të rregullave të etikës së kërkimit shkencor, të të drejtave që burojnë nga pronësia intelektuale apo shkelje të rregullave kundër plagjaturës, si edhe të vetëdeklarojë se është në gjendje të zbatojë standardet shkencore dhe etike.
<p>Dokumentacioni për aplikim</p>	<p>Aplikanti për të ndjekur programin e studimit të doktoratës bën një kërkesë, ku paraget edhe propozimin për temën dhe objektivat e kërkimit shkencor. Kjo kërkesë përfshihet në dosjen personale, e cila përmban edhe dokumentet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • curriculum vitae; • kopje të noterizuar të diplomave, të shoqëruara me suplementet e diplomës ose listën e notave me kreditet përkatëse. Diplomat e fituara jashtë vendit duhet të shoqërohen me vërtetimin e njohjes/ekuivalencimit nga ministria përgjegjëse për arsimin; • certifikatë lindjeje, si edhe fotokopje të kartës së identitetit/pasaportës; • dy rekomandime nga persona me titullin Profesor ose Profesor i Asociuar; • dëshmi të gjuhës së huaj, përputhje me nivelet e parashikuara në Udhëzimin Nr. 52, datë 03.12.2015 “Për përcaktimin e niveleve të gjuhëve të huaja dhe të testeve ndërkombëtare, për pranimet në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar; • dëshmi dhe vërtetime në lidhje me kualifikime, trajnime, provime pasuniversitare ose artikuj shkencorë që mund të ketë kryer, apo pjesëmarrje në konferenca shkencore, eksperiencia akademike; • deklaratë vejtjake e studentit për përballimin e shpenzimeve të programit të studimeve të doktoratës, nëse do të vetëfinancohet; • projekt propozimin e kërkimit shkencor, ku të evidentohen



	<p>objektivat e kërimit shkencor, metodologjia që do të ndiqet, nevoja për studim të thelluar në fushën e propozuar dhe risitë, që priret të sjellë punimi;</p> <ul style="list-style-type: none"> • vërtetim nga gendra e punës, nëse kandidati është i punësuar; • mandat pagese për tarifën e aplikimit; • vetëdeklarim të aplikantit se do të zbatojë standardet shkencore dhe etike; • vetëdeklarimi që nuk është subjekt i asnjë mase disiplinore të marrë ndaj tij.
Procedura e konkurimit	Vlerësimi i dosjes, provim me shkrim, provim me gojë
<ul style="list-style-type: none"> • vlerësimi i dokumentaci onit për aplikim 	<p>vlerësimi i kualifikimeve të bashkangjitura në aplikim nga secili kandidat.</p> <p>Pikët maksimale janë 50 pikë, të ndarë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nota mesatare mbi 8 (10 pikë) - Projekti kërkimor i paraqitur (20 pikë) - publikime të mëparshme (10 pikë) - vlerësimi i përmbledhjes së tenës së masterit (5 pikë) - eksperiencë në mësimdhënie (5 pikë)
<ul style="list-style-type: none"> • provimi me shkrim 	<p>Pikët maksimale janë 25.</p> <p>Testi kalohet me minimumi 10 pikë. Testi konsiston në zhvillimin me shkrim të një tematike të caktuar nga Kolegji Doktoral. Temat publikohen bashkë me shpalljen e konkurimit.</p>
<ul style="list-style-type: none"> • Provimi me gojë 	<p>Pikët maksimale janë 25.</p> <p>Provimi me gojë konsiston në një prezantim të detajuar të projektit të kërimit, të prezantuar nga kandidati si edhe certifikimin e njohurive në gjuhë të huaj.</p>

